



Libri im i Lutjes



Botim i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë
Zyra Qëndrore e Fëmijëve

PËRMBAJTJA

1. Çfarë është lutja.....	5
2. Lutja e Mëngjesit.....	7
3. Lutja e Mbrëmjes	15
4. Lutje në ngrënien e bukës.....	21
5. Lutje të ndryshme.....	25
<i>Lutje për të jetuar ditën e re në Zotin.....</i>	<i>26</i>
<i>Lutje për një ditë të bekuar.....</i>	<i>27</i>
<i>Lutje për të bërë vullnetin e Perëndisë.....</i>	<i>28</i>
<i>Lutje para një detyre.....</i>	<i>29</i>
<i>Lutje pas një detyre.....</i>	<i>29</i>
<i>Lutje përpara studimit.....</i>	<i>30</i>
<i>Lutje pas studimit.....</i>	<i>30</i>
<i>Lutje në kohë nevoje.....</i>	<i>31</i>
<i>Lutje për prindërit.....</i>	<i>32</i>
<i>Lutje për të sëmurë.....</i>	<i>33</i>
<i>Lutje pas shërimit.....</i>	<i>34</i>
<i>Lutje për udhëtim.....</i>	<i>35</i>
<i>Lutje para se të shkojmë në Kishë.....</i>	<i>36</i>
<i>Lutje kur largohemi nga Kisha.....</i>	<i>36</i>

6. Lutje për të gjallët.....	37
7. Lutje për të fjeturit.....	39
8. Studimi i Shkrimit të Shenjtë	41
9. Lutja e Jisuit.....	44
10. Përgatitje për Rrëfimin e Shenjtë.....	46
11. Lutje përpara Kungimit.....	54
12. Urata falënderimi pas Kungimit.....	56
13. Lutje për të falënderuar Perëndinë për gjithçka.....	59
14. Shenja e Kryqit.....	73

I dashur bir i Perëndisë!

Mirësia dhe lumturia më e madhe në jetë është të duam Jisu Krishtin, Perëndinë tonë dhe të lidhemi sa më shumë me Të. Kjo mund të arrihet nëpërmjet lutjes.



Çfarë është lutja?

Lutja është bisedë me Perëndinë. Ai është Ati i dashur dhe lutja është një gjuhë e veçantë të cilën e përdorim kur bisedojmë me Të.

Lutja është miqësi me Perëndinë. Ajo rritet kur miqësia dhe njohuria për Perëndinë rriten. Ajo kërkon kohë, energji, dashuri, durim dhe dëshirë.

Ndonjëherë lutja është e vështirë, sepse nuk kemi rritur dëshirën për Perëndinë mbi çdo gjë tjetër.

Ne përdorim lutjet e Kishës që të na mësojnë si të lutemi dhe të na japin fjalët e adhurimit kur mund të mos i kemi ato.

Prandaj ky libër me lutje të ndryshme do të të mësojë të lutesh, duke u përpjekur ta përdorësh çdo ditë.

Qëndro përballë ikonave. Bëj me kujdes shenjën e kryqit, më pas me ngadalë dhe me vëmendje thuaj disa nga lutjet e këtij libri.

Së shpejti koha e lutjes do të bëhet koha më e mirë dhe më e lumtur e ditës sate.

Të lutem, përdori këto lutje dhe lejo që dashuria e Perëndisë të rritet në ty.

Si të lutesh?

Vetëm Shpirti i Shenjtë mund të të udhëheqë të lutesh siç duhet.

Ashtu si një fëmijë mëson të ecë duke ecur, kështu ti mund të mësosh të lutesh duke u lutur çdo ditë.

Gjithë shpirtin tënd përkushtoje në lutje!

Mendo për kuptimin e fjalëve me të cilat lutesh!

Bëje lutjen personale!

Ji këmbëngulës në lutje!

Kujdes nga pakujdesia dhe neglizhenca!

Forcoje lutjen tënde me besim të gjallë te Zoti, me shpirt falës ndaj të tjerëve dhe me një jetë vërtetë të krishterë!

Lutja është një armë e rëndësishme që ke, me anë të së cilës mund të ndihmosh veten dhe të tjerët në çdo rrethanë.

Prandaj, kultivo çdo ditë komunikimin me Perëndinë, Atin tënd të dashur dhe prano të vërtetën se Ai pret çdo thirrje tënden dhe i përgjigjet gjithmonë asaj.



Lutja e Mëngjesit



Sa bukur kur zgjohesh në mëngjes të mendosh menjëherë për Perëndinë dhe t'i kërkosh bekim për ditën e re.

I gjunjëzuar ose në këmbë, fillo me një çast qetësie.

Ofroji një lutje të shkurtër Perëndisë.

Bëj shenjën e kryqit dhe lutu pa u nxituar, duke pasur mendjen te fjalët e lutjes.

Lutja e Mëngjesit

Në emrin e Atit, të Birit edhe Shpirtit të Shenjtë. Amin.
Lavdi më Ty, o Krisht Perëndia ynë, lavdi më Ty.



Lutje drejtuar Shpirtit të Shenjtë

○ Mbret qiellor, Ngushëllimtar, Shpirt i së vërtetës, që ndodhesh kudo dhe i mbush të gjitha, thesar i të mirave dhe dhurues jete; eja dhe qëndro ndër ne dhe pastrona nga çdo njollë dhe shpëto, o i Mirë, shpirtrat tanë. Amin.

Himni engjëllor për Trininë e Shenjtë ose Trishenjtë

Shenjt Perëndi, Shenjt i fuqishëm, Shenjt i pavdekshëm, mëshirona. (3 herë)

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Trini e Tërëshenjtë, mëshirona; o Zot, falna mëkatet tona; o Zot i madh, ndjei paudhësitë tona; o i Shenjtë, vështro dhe shëro sëmundjet tona, për emrin tënd.

Mëshiro, o Zot. (3 herë)

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Lutja Zotërore

(Vetë Zoti ynë Jisu Krisht na mësoi këtë lutje! Çfarë mund të jetë më e mirë sesa të lutesh ashtu si Zoti na mësoi? Çfarë mund të të bëjë më të lumtur sesa fakti që Perëndia është Ati yt, i Cili të do?)



Ati ynë që je në qiejt,
u shenjtëroftë emri yt,
ardhtë mbretëria jote,
u bëftë dëshira jote
si në qiell ashtu edhe mbi dhé.
Bukën tonë të përditshme
jepna neve sot; dhe falna fajet tona,
sikurse edhe ne ua falim fajtorëve tanë;
dhe mos na shtjer në ngasje, po shpëtona nga i ligu.

Tropari i Trinisë së Shenjtë

Si u ngritëm prej gjumit, Ty po të biem në gjunjë, o i Mirë,
dhe himnin e Engjëjve po të thërresim, o i fortë: Shenjt,
Shenjt, Shenjt je, o Perëndi, me anën e Hyjlindëses
mëshirona.

Laodi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë.

Pasi më ngrite prej shtratit dhe prej gjumit, o Zot,
ndriçomë mendjen, dhe hapmi zemrën dhe buzët që të të
himnojnë Ty, o Trini e Shenjtë: Shenjt, Shenjt, Shenjt je, o
Perëndi, me anën e Hyjlindëses mëshirona.

Tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Papritur Gjykatësi do të vijë dhe veprat e secilit do të
zbulojë, por le të thërresim me frikë në mes të natës: Shenjt,
Shenjt, Shenjt je, o Perëndi, me anën e Hyjlindëses
mëshirona.

Lutje falënderimi

Duke u ngritur prej gjumit të falënderoj Ty, o Trini e Shenjtë, se nga mirësia jote e madhe dhe nga zemërgjerësia, nuk je zemëruar me mua përtacin e mëkatarin, as më bërë të humbas bashkë me paudhësitë e mia, por nga njeridashja, si zakonisht, kur isha në dëshpërim më ngrite, që të qëndroj në mëngjes e të lavdëroj pushtetin tënd.

Dhe tani ndriçomi sytë e mendjes, çelma gojën për të mësuar fjalët e tua, për të kuptuar urdhërimet e tua, për të bërë dëshirën tënde, për të të psalur me lavdërim zemre dhe për të himnuar emrin tënd të Tërëshenjtë, të Atit, dhe të Birit dhe të Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Lavdi Ty, o Mbret, Perëndi i tërëfuqishëm, që me kujdesin tënd hyjnor dhe njeridashës, më bërë të denjë, mua mëkatarin e të padenjtin, të ngrihem prej gjumit e të hyj në shtëpinë tënde të shenjtë.

Prano, o Zot, edhe zërin e lutjes sime, si zërin e Fuqive të tua të shenjta dhe shpirtërore; dhe denjo që me zemër të pastër dhe me shpirt përlulesie, të të sjell lavdërimin me buzët e mia të ndyra; që të bëhem edhe unë pjesëmarrës bashkë me virgjëreshat e urta, në shkëlqimin gazmor të shpirtit tim dhe të të lavdëroj Ty, Perëndinë-Fjalë, që lavdërohesh bashkë me Atin e me Shpirtin e Shenjtë. Amin.



Simboli i Besimit

(Këtu janë mësimet bazë të besimit tonë orthodhoks. Përpiqu ta mësosh të gjithë Simbolin e Besimit përmendësh.)

Besoj në një Perëndi, Atë të tërëfuqishëm, krijues të qiellit edhe të dheut dhe të gjitha të dukurave dhe të padukurave.

Dhe në një Zot, Jisu Krishtin, Birin e Perëndisë, të Vetëmlindurin, që lindi prej Atit përpara gjithë shekujve.

Dritë prej drite, Perëndi të vërtetë prej Perëndie të vërtetë, të lindur, jo të bërë, që ka të qenët një me Atin, me anën e të cilit u bënë të gjitha.

Që për ne njerëzit dhe për shpëtimin tonë, zbriti prej qiejve dhe u trupëzua prej Shpirtit të Shenjtë dhe Virgjreshës Mari dhe u bë njeri.

Dhe u kryqëzua për ne në kohën e Pontit Pilat, dhe pësoi e u varros. Dhe u ngjall të tretën ditë sipas Shkrimeve. Dhe u ngjit në qiejt dhe rri në të djathtë të Atit.

Dhe do të vijë përsëri me lavdi të gjykojë të gjallët dhe të vdekurit, mbretëria e të cilit nuk do të ketë mbarim.

Dhe në Shpirtin e Shenjtë, Zot, Jetëbërës, që buron prej Atit, që adhurohet e lavdërohet bashkë me Atin e me Birin, që foli me anën e profetëve.

Në një Kishë të shenjtë, Katholike dhe apostolike.

Pohoj një pagëzim për ndjesën e mëkateve.

Pres ngjalljen e të vdekurve.

Dhe jetën e ardhshme të amëshuar. Amin.

Himn lavdërimi për Hyjlindësen

(Ky himn thotë se Zonja jonë është më e larta e të gjitha krijesave, madje më e lartë dhe se engjëjt, sepse ajo bëri plotësisht dëshirën e Perëndisë çdo ditë të jetës së saj dhe u denjësuua të jetë nëna e Birit të Tij Hyjnor.)



Më të nderuarën se Keruvimet
dhe më të lavdëruarën
pa krahasim se Serafimet,
që pa u cenuar linde Fjalën Perëndi,
me të vërtetë Hyjlindëse,
ty të madhërojmë.

Lutja e një fëmije

Zot Jisu, të falënderoj për dhuratën e kësaj dite të re.
Kur erdhe në tokë për ne, u rrite si fëmijë në urtësi dhe hir.
Si Zot, more fëmijët në krahët e tua.
I bekove dhe u the se mbretëria jote u përket atyre.
I dashur Jisu, prit më dhe mua këtë ditë dhe dëgjo lutjen
time të mëngjesit.
Beko prindërit e mi, mësuesit dhe të gjithë ata që më duan
dhe kujdesen për mua.



Lutja e shën Filaretit të Moskës

Dhuromë, o Zot, përshëndetjen e ditës së re me paqe. Ndhimomë që për gjithçka të bazohem te vullneti Yt hyjnor. Në çdo orë të ditës, zbulomë vullnetin tënd.

Beko marrëdhëniet e mia me ata që më rrethojnë. Mësomë të trajtoj çdo njeri që takoj me paqe në shpirt dhe me bindjen e plotë, se vullneti Yt udhëheq gjithçka.

Në çdo fjalë e vepër, drejto mendimet dhe ndjenjat e mia. Në ngjarje të papritura, mos lejo të harroj se të gjitha gjërat janë nën kujdesin Tënd.

Mësomë të veproj me vendosmëri dhe me urtësi, pa zemëruar apo trazuar të tjerët. Jepmë fuqinë të përballoj lodhjen e ditës që vjen, me gjithçka që ajo mund të sjellë.

Drejto dëshirat e mia, mësomë të lutem, lutu brenda meje. Amin.

Lutja e Jisuit

(Emri i Jisuit ka më shumë pushtet se çdo gjë në botë. Nëse e thua këtë lutje herë pas here - gjatë gjithë kohës - vetë Jisui vjen të jetojë në zemrën tënde. Mund ta thuash kur ngrihesh në mëngjes, kur përgatitesh për në shkollë, kur ecën rrugës, kur shkon në shtrat etj.)

Zot Jisu Krisht, Bir i Perëndisë,
mëshiromë mua mëkatarin!

(12 herë)



Lutje e shkurtër për Nënë e Perëndisë

(Nëna e Perëndisë është edhe nëna jote. Lutju asaj çdo ditë dhe për çdo nevojë. Ajo nuk do të të harrojë kurrë.)

Ɖ Përmbishenjtë Hyjlindëse, shpëtona!

Lutje e shkurtër për Shenjtorin përkatës

(Kur u pagëzove, more emrin e një shenjtori, i cili tani është miku yt i veçantë. Ai jeton në qiell dhe lutet për ty. Përpiqu të flasësh me të çdo ditë dhe kërko ndihmën e tij.)

Shën *(emri i shenjtorit)* lutu për mua.

Një këngë lavdërimi

Psalmi 150

Lavdërojeni Perëndinë në shenjtoren e Tij, lavdërojeni atë në vendin e shkëlqimit të fuqisë së Tij.

Lavdërojeni për fuqitë e Tij; lavdërojeni sipas madhërisë së Tij të shumtë.

Lavdërojeni me zë trumpete; lavdërojeni me harpë dhe me kitarë.

Lavdërojeni me timpan dhe valle; lavdërojeni me kordha dhe instrumente.

Lavdërojeni me cimbale tingëlluese, lavdërojeni me cimbale brohoritjeje.

Çdo frymë le të lavdërojë Zotin.

Urata e mbylljes

Me uratat e Etërve tanë të shenjtë, o Zot Jisu Krisht Perëndi, mëshirona dhe shpëtona. Amin.



Lutja e Mbrëmjes



Kur përgatitesh për të fjetur, sado vonë që mund të jetë, gjej kohë t'i lutesh Perëndisë.

Sado i lodhur të jesh nga shqetësimet e ditës, lutja e mbrëmjes është një burim paqeje dhe gëdhjeje.

Pas një momenti qetësie ofro lutjen tënde të mbrëmjes me shpirt të qetë.

Lutjet në vijim do të të ndihmojnë të jesh i vëmendshëm.

Në emrin e Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë. Amin.

Lavdi më Ty, o Krisht Perëndia ynë, lavdi më Ty.



Lutje drejtuar Shpirtit të Shenjtë

○ Mbret qiellor, Ngushëllimtar, Shpirt i së vërtetës, që ndodhesh kudo dhe i mbush të gjitha, thesar i të mirave dhe dhurues jete; eja dhe qëndro ndër ne dhe pastrona nga çdo njollë dhe shpëto, o i Mirë, shpirtrat tanë. Amin.

Himni engjëllor për Trininë e Shenjtë ose Trishenjtë

Shenjt Perëndi, Shenjt i fuqishëm, Shenjt i pavdekshëm, mëshirona. (3 herë)

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Trini e Tërëshenjtë, mëshirona; o Zot, falna mëkatet tona; o Zot i madh, ndjei paudhësitë tona; o i Shenjtë, vështro dhe shëro sëmundjet tona, për emrin tënd.

Mëshiro, o Zot. (3 herë)

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Lutja Zotërore

Ati ynë që je në qiejt, u shenjtëroftë emri yt, ardhhtë mbretëria jote, u bëftë dëshira jote si në qiell ashtu edhe mbi dhe. Bukën tonë të përditshme jepna neve sot; dhe falna fajet tona, sikurse edhe ne ua falim fajtorëve tanë; dhe mos na shtjer në ngasje, po shpëtona nga i ligu.

O Dritë Gazmore



O Jisu Krisht, dritë gazmore e lavdisë së shenjtë të Atit të pavdekshëm qiellor, të shenjtë e të lumtur, si arritëm në perëndimin e diellit dhe pamë dritën e mbrëmjes, himnojmë Atin, Birin dhe Shpirtin e Shenjtë, Perëndinë. Ti meriton në çdo kohë të himnoshesh me zëra të mbara, o Bir i Perëndisë, që jep jetë; prandaj bota të lavdëron.

Lutje drejtuar Shpëtimtarit

Si shkova ditën, të falënderoj, o Zot; të lutem falmë mbrëmjen dhe natën të pamëkatshme, o Shpëtimtar dhe shpëtomë.

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë.

Si shkova ditën, të lavdëroj, o Zot; të lutem falmë mbrëmjen dhe natën pa skandal, o Shpëtimtar dhe shpëtomë.

Tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Si shkova ditën, të përhimnoj, o i Shenjtë; të lutem falmë mbrëmjen dhe natën pa lakmim, o Shpëtimtar dhe shpëtomë.

Psalmi 140

(Ky psalm nga Shërbesa e Mbrëmësore të kujton se Perëndia pret thirrjen tënde në çdo moment. Ofroje lutjen dhe zemrën tënde te Krishti, si simbol sakrifice për Të.)



O Zot, thirra te Ti, dëgjomë, dëgjomë, o Zot. O Zot, thirra te Ti, dëgjomë, vëri re zërit të lutjes sime; kur thërres te Ti, o Zot, dëgjomë.

Loë të drejtohet lutja ime si temjan përpara teje; ngritja e duarve të mia si therore e mbrëmshme. O Zot, dëgjomë.

Lutja e një fëmije

Zoti ynë Jisu, Ti prite fëmijët që erdhën te Ti. Na prit edhe ne, fëmijët e Tu dhe dëgjo lutjen tonë të mbrëmjes.

Na mbro nën strehën e krahëve të Tu, që të flemë në paqe dhe të ngrihemi në mëngjes që të lavdërojmë Ty, Zotin tonë të dashur. Amin.



Lutja e Jisuit

(Thuaje këtë lutje duke bërë një përkulje.)

Zot Jisu Krisht, Bir i Perëndisë,
mëshiromë për mua mëkatarin!

(12 herë)

Lutje pendimi

○ Zot, Perëndia im, nga mëshira dhe dhembshuria jote e madhe, falmë të gjitha mëkatet që kam bërë këtë ditë me fjalë, mendje apo vepra. *(Thuaj në heshtje mëkatet e tua përpara Perëndisë dhe pendohu për to.)*

Dhuromë gjumë të qetë e të paqshëm dhe mbromë nga çdo tundim dhe sulm i të ligut. Ngremë përsëri në mëngjes, që të të jap lavdi. Se i bekuar je bashkë me Birin dhe Shpirtin tënd të Shenjtë, gjithnjë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Lutje Engjëllit Mbrojtës

(Kur u pagëzove, Perëndia të dha një engjëll mbrojtës, i cili do të jetë gjithmonë me ty, duke të mbrojtur nga sulmet e të ligut çdo ditë dhe çdo moment të jetës sate.)



○ Engjëll i shenjtë, mbrojtës i shpirtit tim të mjerë dhe i jetës sime të vuajtur, mos më lër mua mëkatarin, as mos u largo prej meje për ngathtësinë time, mos i lësho vend djallit të lig për të pushtuar e sunduar trupin tim të vdekshëm, mbamë nga dora ime e mjerë dhe e mpirë dhe drejtomë tek udha e shpëtimit.

Po, o Engjëll i Shenjtë i Perëndisë, ruajtës dhe mbrojtës i shpirtit dhe i trupit tim të mjerë, ndjemë me gjithçka me të cilën të kam hidhëruar gjatë gjithë ditëve të jetës sime, si dhe për çdo faj të bërë ditën e sotme, mbromë këtë natë dhe ruajmë nga çdo ndikim i armikut, që të mos e zemëroj Perëndinë me ndonjë faj dhe ndërmjeto te Zoti për mua të më forcojë me frikën e tij dhe të më tregojë shërbëtor të denjë të mirësisë së tij. Amin.

O Atë, shpresa ime.
O Bir, përikja ime.
O Shpirt i Shenjtë, mbrojtja ime.
Trini e Shenjtë, lavdi më Ty.



Çëzohu, o Hirplotë Hyjlindëse Virgjëreshë Mari, Zoti është me ty. E bekuar je ti në mes të grave dhe e bekuar është pema e barkut tënd se linde Shpëtimtarin e shpirttrave tanë.

Psalmi 22



Zoti është bariu im, asgjë s'do të më mungojë.

Më vuri të rri në vend të blertë, më rriti në ujëra të qetë.

Ma përtëriti shpirtin, nëpër rrugë drejtësie më udhëhoqi, për emrin e vet.

Se edhe në ecsha përmes hijes së vdekjes, nga asnjë e keqe s'do të kem frikë, se ti je bashkë me mua; shkopi yt dhe purteka

jote, ato më ngushëllojnë. Bëre gati para meje tryezën kundër atyre që më shtrëngojnë.


Me vaj e leve kokën time; dhe kupa jote do të më ujitë si shumë të fortë.

Dhe përdëllimi pas do të më ndjekë gjithë ditët e jetës sime; dhe në shtëpinë e Zotit do të rri për gjithë jetën.

Urata e mbylljes

Me uratat e Etërve tanë të shenjtë, o Zot Jisu Krisht Perëndi, mëshirona dhe shpëtona. Amin.

Lutje në ngrënien e bukës



Çdo vakt ngrënieje është imazh i Liturgjisë Hyjnore, një falënderim për bukën e përditshme dhe një lutje për bukën hyjnore të hirit të Perëndisë.

Perëndia të jep ushqim, ashtu si dhe çdo gjë tjetër për të cilën ke nevojë.

Kërko bekimin e Tij për gjithçka që ha, kështu që Ai do të të dhurojë shëndet në shpirt dhe në trup. Gjithashtu falenderoje Perëndinë pasi të kesh ngrënë, që t'i tregosh se je mirënjohës për ushqimin dhe për të gjitha dhuratat e shumta e të mira, që të jep në çdo çast të jetës.

Në mëngjes

Para buke

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Mëshiro, o Zot (3x).

O Krisht, Perëndia ynë, beko ngrënien dhe pirjen e shërbëtorëve të Tu, se i shenjtë je gjithmonë, tani e përherë dhe në jetë të jetëve. Amin.

Pas buke

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Mëshiro, o Zot (3x).

O Krisht Perëndi, beko tepricat e pjesëve të kësaj tavoline dhe shtoi këto në këtë shtëpi (shkollë, famulli, manastir, qytet, fshat, vend), se i bekuar je gjithmonë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Me uratat e Etërve tanë të shenjtë, o Zot Jisu Krisht Perëndi mëshirona dhe shpëtona. Amin.



Në drekë

Para buke

Ati ynë që je në qiejt, u shenjtëroftë emri yt, ardhhtë mbretëria jote, u bëftë dëshira jote si në qiell ashtu edhe mbi dhe. Bukën tonë të përditshme jepna neve sot. Dhe falna fajet tona sikurse edhe ne ua falim fajtorëve tanë. Dhe mos na shtjer në ngasje, po shpëtona nga i ligu.

Lavdi Atit e Birit dhe Shpirtit të Shenjtë. Tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Mëshiro, o Zot (3x).

O Krisht, Perëndia ynë, beko ngrënien dhe pirjen e shërbëtorëve të Tu, se i shenjtë je gjithmonë, tani e përherë dhe në jetë të jetëve. Amin.

Falënderim pas buke

Të falënderojmë, o Krisht Perëndia ynë, se na ngope me të mirat e tua të mbidheshme, bëna të denjë dhe për mbretërinë Tënde qiellore, dhe ashtu siç erdhe, o Shpëtimtar në mes të nxënësve të Tu dhe u dhurove paqen, eja në mes nesh dhe shpëtona. Amin.

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Mëshiro, o Zot (3x).

O Krisht Perëndi, beko tepricat e pjesëve të kësaj tavoline dhe shtoi këto në këtë shtëpi (shkollë, famulli, manastir, qytet, fshat, vend), se i bekuar je gjithmonë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Me uratat e Etërve të shenjtë, O Zoti Jisu Krisht Perëndi, mëshirona dhe shpëtona. Amin.

Në darkë

Para buke

Le të hanë të varfrit dhe le të ngopen dhe le të lavdërojnë Zotin ata që e kërkojnë; zemrat e tyre do të rrojnë në jetë të jetëve. Amin.

Lavdi Atit e Birit dhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Mëshiro, o Zot (3x).

O Krisht, Perëndia ynë, beko ngrënien dhe pirjen e shërbëtorëve të Tu, se i shenjtë je gjithmonë tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Falënderim pas buke

Na ngazëllove, o Zot, me veprat e tua, dhe me punët e duarve të tua u gëzuar. U shënua mbi ne drita e fytyrës sate, iu dhe gëzim zemrave tona. Nga pema e grurit, verës dhe vajit u mbushëm dhe tani do të biem të flemë se Ti, o Zot, gjendesh me shpresë te secili prej nesh.

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Mëshiro, o Zot (3x).

O Krisht Perëndi, beko tepricat e pjesëve të kësaj tavoline dhe shtoi këto në këtë shtëpi (shkollë, famulli, manastir, qytet, fshat, vend), se i bekuar je gjithmonë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Me uratat e Etërve tanë të shenjtë, o Zot Jisu Krisht Perëndi mëshirona dhe shpëtona. Amin.

Lutje të ndryshme



Besimi ynë orthodhoks ka lutje të veçanta, të cilat mund të bëhen gjatë ditës dhe në rrethana të ndryshme.

Lutje për të jetuar ditën e re në Zotin

O Zot, ndihmomë të përballoj me qetësi shpirtërore gjithë gjërat që do të më sjellë dita e sotme.

Ndihmomë të dorëzohem tërësisht në dëshirën tënde të shenjtë.

Në çdo orë të ditës ndriçomë dhe forcomë për çdo gjë.

Çfarëdolloj lajmesh nëse marr sot, mësomë t'i pranoj me qetësi dhe me besim të patundur, se asgjë nuk ndodh pa e lejuar Ti.

Udhëhiq më mendimet dhe ndjenjat në gjithë punët dhe fjalët e mia.

Në rastet e papritura mos më lër të harroj se të gjitha lejohen nga Ti.

Mësomë të sillem me çdo pjesëtar të familjes sime dhe me të gjithë të afërmit e mi me drejtësi dhe urtësi, me qëllim që të mos turbulloj dhe të mos mërzit asnjë.

O Zot, jep më fuqinë të duroj mundimin dhe gjithë ngjarjet e kësaj dite, në gjithë kohëzgjatjen e saj.

Udhëhiq dëshirën time dhe mësomë të lutem, të besoj, të duroj, të fal dhe të kem dashuri. Amin.

Etërit e Optinës



Lutje për një ditë të bekuar

○ Zot Jisu Krisht Perëndia im, jepmë një ditë të mirë, të pamëkatshme dhe të panjollëshme shpirtërisht.

Mos më braktis.

Mos u largo nga unë.

Shtrije dorën tënde dhe ndihmomë.

Forcomë me frikën tënde.

Zot, mbill thellë zemrës sime frikën dhe dashurinë tënde

Mësomë si të bëj dëshirën tënde.

Jepi zemrës sime përulësi dhe hidhërim për mëkatet e mia.

Jepmë lot pendimi të vazhdueshëm, zemër të dërrmuar dhe kujtim vdekjeje.

Çliromë nga çdo tundim shpirtëror dhe trupor.

Largo nga unë çdo mendim të papastër, çdo mendim që shkakton turp dhe është i pajustificueshëm.

Hiq nga unë plogështinë, dembelizmin, hidhërimin, harresën, pandjeshmërinë, ngurtësinë, dhe mos lër të robërohet mendja ime nga çfarëdogjë mëkatare.

Zot, me çfarëdo mënyre që Ti di dhe do, mëshiromë dhe fal gjithë paudhësitë e mia; dhe bëj që, kur të vijë ora, shpirti im mëkatar të braktisë trupin tim të munduar me paqe, me pendim të vërtetë, me rrëfim të sinqertë dhe me besim të pastër dhe të patundur. Amin.

Lutje për të bërë vullnetin e Perëndisë

○ Zot, nuk di ç'të kërkoj prej teje.

Vetëm Ti i njeh nevojat e mia të vërteta.

Ti më do më shumë, sesa di të dua.

Ndihmomë të shoh nevojat, që mund të jenë të fshehta për mua.

Nuk guxoj të të kërkoj as kryq, as ngushëllim;
me zemrën hapur, vetëm Ty mund të pres.

Vizitomë dhe ndihmomë me dashurinë tënde të patundur.

Goditmë dhe shëromë; rrezomë dhe ngrimë.

Në qetësi adhuroj vullnetin tënd të shenjtë.

Të ofroj veten time si një flijim të gjallë.

Gjithë besimin tim e vendos te Ti.

Nuk kam dëshirë tjetër, veç bërjes së vullnetit tënd.

Mësomë të lutem. Lutu brenda meje. Amin.

Shën Filareti i Moskës



Lutje para një detyre

○ Zot Jisu Krisht Perëndia ynë, Ti the: “Pa mua, ju nuk mund të bëni asgjë”. Me besim, o Zot, përqafoj fjalët e tua dhe i lutem mirësisë sate. Ndhimmomë të çoj deri në fund punën, që po filloj.

Se ty ta drejtoj lavdinë, Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin

○ Perëndi i tërëfuqishëm, ndihma dhe streha jonë, burim i çdo urtësie dhe kolonë fuqie.

Ti e di, se pa ty unë jam i pafuqishëm, se larg teje unë nuk mund të bëj asgjë.

Dërgo hirin tënd, që të më aftësojë, për të përmbushur këtë detyrë që po ndërmarr.

Më ndihmo ta përqafoj atë me besnikëri dhe me zell, që të dalë e dobishme për mua dhe për të tjerët dhe që t’i sjell lavdi Emrit tënd të shenjtë.

Se e jotja është mbretëria dhe fuqia dhe lavdia, e Atit, Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve.

Amin.



Lutje pas një detyre

○ Të falënderoj, o Zot, që më dhe fuqi dhe më udhëhoqe në punët e mia. Ti je përmbushja e gjithë të mirave.

Mbushe shpirtin tim me gëzim e kënaqësi, që të të lavdëroj përjetë. Amin.

Lutje përpara studimit

O Krisht, drita e vërtetë, që ndriçon dhe shenjtëron çdo njeri që vjen në botë, ardhhtë drita e Fytyrës sate mbi mua, në mënyrë që të shoh dritën tënde të paafreshme.

Udhëhiq hapat e mi sipas urdhërimeve të tua, me ndërmjetimet e Nënës sate të tërëshenjtë dhe të gjithë shenjtoreve të tu. Amin.

O Zot, Perëndia ynë, burim i çdo urtësie dhe i çdo të vërtete, dërgo mbi mua Shpirtin e së vërtetës, Shpirtin e urtësisë, Shpirtin e mendjemprehtësisë.

Ndriço sytë e shpirtit tim me dritën e njohurisë sate, që të mund të mësoj nga Urtësia jote dhe të rritem në virtyte, për lavdinë e emrit tënd. Amin.



Lutje pas studimit

Të falënderoj, o Zot, Perëndia ynë, se përsëri hape sytë e mi për të parë dritën e urtësisë sate.

Zemrën time e kënaqe me njohjen e së vërtetës sate.

Të lutem, o Zot, ndihmomë të bëj gjithmonë dëshirën tënde.

Beko shpirtin dhe trupin tim, fjalët dhe veprat e mia.

Bëmë të denjë të rritem në hir, në virtyte dhe në zakone të mira, që të mund të lavdëroj emrin tënd, të Atit, të Birit edhe të Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve.

Amin.

Lutje në kohë nevoje



Perëndi i tërëfuqishëm, Atë i mëshirave dhe i çdo ngushëllimi, eja ndihmomë dhe çliromë nga kjo vështirësi, që më shqetëson.

Besoj, o Zot, se të gjitha provat e jetës janë nën kujdesin tënd dhe se gjithçka punon për të mirën e atyre që të duan.

Largo prej meje frikën, ankthin dhe hidhërimin.

Ndihmomë t'i përballoj vështirësitë e mia me besim, kurajë dhe me urtësi.

Bëj që kjo provë të më sjellë më pranë teje, sepse Ti je mbrojtësi im dhe streha ime, ngushëllimtari im dhe shpresa ime, kënaqësia dhe gëzimi im.

Te dashuria dhe dhembshuria jote vë shpresën e besimit tim.

Se i bekuar është emri yt, i Atit, i Birit edhe i Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Lutje për prindërit

○ Zot dhe Shpëtimtar, ty, që na ke mësuar të nderojmë atin dhe nënën tonë dhe të tregojmë dashuri dhe bindje ndaj tyre, po të lutem nga thellësitë e zemrës sime, o Jisu i ëmbël, Perëndia im, dëgjoma lutjen.

Beko, prindërit e mi, që më kanë rritur me ndihmën e hirit tënd.

Mbroji nga çdo rrezik, sëmundje apo e keqe.

Dhuroju besim, shëndet dhe gëzim.

Beko, çdo punë të tyre, që ata të mund të të japin nder dhe lavdi, për gjithë ditët e jetës. Amin.



Lutje për të sëmurë



○ Atë qiellor, mjek i shpitrave dhe i trupave tanë, që dërgove Birin tënd të Vetëmlindur Jisu Krisht për të shëruar çdo sëmundje dhe lëngatë, vizito e shëro edhe shërbëtorin tënd (*emri...*) nga të gjitha sëmundjet shpirtërore dhe fizike, nëpërmjet hirit të Krishtit tënd.

Dhuroji durim në sëmundje, fuqi të shpirtit, të trupit dhe fitim të shëndetit.

Ti na mësove, me fjalën tënde, të lutemi për njëri-tjetrin, që të shërohemi.

Të lutem, shëro shërbëtorin tënd (*emri...*) dhe jepi dhuratën e shërimit të plotë.

Se Ti je burimi i shërimit dhe ty ta drejtoj lavdinë, Atit, Birit edhe Shpirtit të Shenjtë. Amin.

Lutje pas shërimit



Perëndi i tërëfuqishëm dhe Atë qiellor, Ti je burim jete dhe shërimi.

Emrin tënd të shenjtë bekoj dhe ty të ofroj falënderim, se më çlirove nga sëmundja dhe më riktheve shëndetin.

Të lutem, më jep hirin tënd, që të mund të jetoj një jetë të re me bindje të plotë ndaj teje.

Më udhëhiq të bëj vullnetin tënd në gjithçka, duke e vënë jetën time në shërbimin tënd, që, duke jetuar për ty, të bëhem i denjë për Mbretërinë tënde, ku Ti jeton me lavdi, bashkë me Birin dhe me Shpirtin tënd të Shenjtë, përjetë. Amin.

Lutje për udhëtim

○ Zoti Jisu Krisht, Ti që udhëtove me dy dishepujt për në Emaus dhe që ndeze zemrat e tyre me zjarrin e hirit tënd, udhëto edhe me mua dhe gëzoje zemrën time me praninë tënde.

E di, o Zot, se jam një pelegrin në këtë botë, duke kërkuar atdheun tim të vërtetë, që është në qiejt. Gjatë udhëtimit më mbulo me engjëjt e tu të shenjtë dhe më mbro nga rreziqe të dukshme dhe të padukshme.

Dhuromë çuarjen deri në fund të planeve të mia dhe plotësimin e parashikimeve të mia sipas vullnetit tënd.

Ndihmomë të shikoj bukurinë e krijesës dhe të kuptoj mrekullinë e së vërtetës Sate në çdo gjë.

Se Ti je rruga, e vërteta dhe jeta dhe ty ta drejtoj lavdinë, falënderimin dhe adhurimin, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.



Lutje para se të shkojmë në Kishë



Do të vij në shtëpinë tënde falë shumicës së mëshirave të tua; dhe me nderim do të adhuroj drejt tempullit tënd të shenjtë.


Më drejto, o Zot, në drejtësi për shkak të armiqve të mi.

Bëje rrugën e tyre drejt para meje, që me një mendje të kthjellët të mund të të lavdëroj përjetë, një Perëndi; Atin, Birin edhe Shpirtin e Shenjtë. Amin.

Lutje kur largohemi nga Kisha

Tani përleshroje shërbëtorin tënd, o Zot, sipas fjalës sate, me paqe, se sytë e mi panë shpëtimin tënd, të cilin Ti e përgatite faqe gjithë popujve, dritë për ndriçimin e paganëve dhe për lavdi të popullit tënd Izrael. Amin.

Lutje për të gjallët



O Zot Jisu Krisht, Perëndia ynë, me mëshirën dhe dhembshurinë Tënde, vlerëso lutjet e përlutura të të gjithë atyre që të thërrasin me gjithë zemër; ul veshin dhe dëgjo tani lutjen time që të ofroj me përlulesi.

Kujto o Zot, Kryepiskopin tonë (emri i Kryepiskopit) dhe çdo episkop orthodhoks, priftërinjtë dhe dhjakonët dhe gjithë klerin e Kishës Sate që ke themeluar për të ushqyer grigjën me Fjalën Tënde; dhe me lutjet e tyre ki mëshirë për mua mëkatarin dhe shpëtomë.

Kujto o Zot, të gjitha autoritetet civile, forcat tona të armatosura, këtë qytet në të cilin banojmë dhe çdo qytet dhe vend; falu atyre kohë me paqe, në mënyrë që ne, në qetësinë e tyre të mund të bëjmë një jetë të qetë dhe me paqe, me shenjtëri dhe perëndishmëri.

Kujto o Zot, prindërit e mi (emrat e prindërve), vëllezërit dhe motrat e mia, të afërmit dhe miqtë (thoni emrat e atyre për të cilët doni të luteni); bëje që të kenë mëshirë, jetë, paqe, shëndet, shpëtim, vështrim, falje dhe shlyerje të mëkateve; që të të lavdërojnë gjithmonë dhe të madhështojnë Emrin tënd të Shenjtë.

Kujto, o Zot, ata që udhëtojnë në tokë, në det dhe në ajër; të moshuarit dhe të rinjtë; jetimët dhe vejushat, të sëmurët, vuajtësit, të hidhëruarit, të munduarit, robërit dhe të varfrit në nevojë; dhe dërgo mbi ta mëshirat e tua, sepse Ti je dhënësi i gjithë gjërave të mira.

Më kujto, o Zot, mua shërbëtorin Tënd të përulur; jepmë hirin Tënd që të mund të jem i përpiktë dhe besnik, duke shmangur influencën dhe shoqërinë e ligë, duke i rezistuar tundimit, që të mund të bëj jetë të drejtë dhe të shenjtë, me paqe dhe të pamëkatshme, duke të shërbyer Ty gjithmonë, që të mund të numërohem i denjë për të hyrë në Mbretërinë e Qiejve. Amin.

(Prindërit e tu, familja dhe miqtë kanë vërtet nevojë për lutjet e tua. Kur të lutesh, fto hirin e Perëndisë t'i bekojë ata. Lutja është vepra më e rëndësishme e dashurisë që mund të bësh për këdo. Shkruaj emrat e personave të dashur në hapësirën më poshtë.)

O Zot, ruaj dhe ki mëshirë për prindërit, të afërmit, mësuesit, miqtë dhe të gjithë të krishterët orthodhoksë.

Lutje për të fjeturit

(Dashuria për dikë nuk mbaron kur ai person vdes, sepse “në Krishtin të gjithë janë gjallë”. Perëndia i dëgjon lutjet për të dashurit e tu, të cilët kanë fjetur në Zotin.)

Kujto, o Zot, shërbëtorët e tu (*thuaj emrat e të fjeturve që ke dëshirë të kujtosh*) që kanë fjetur me shpresën e ngjalljes në jetën e pasosur, dhe gjithë ata që kanë mbaruar jetën e tyre me shpresëtari dhe besim; fal të gjitha shkeljet e tyre të bëra me dashje dhe pa dashje, qoftë me fjalë, vepra apo mendime.

Strehoji në vend të ndritshëm, në vend qetësie, prehje nga nuk ka as sëmundje, as hidhërim dhe psherëtimë dhe ku pamja e Fytyrës Sate gëzon të gjithë Shenjtorët e të gjithë brezave.

Falu atyre Mbretërinë Tënde dhe pjesë në bekimet e tua të përjetshme dhe të papërshkrueshme dhe gëzimin e jetës sate të pasosur, sepse Ti je Ngjallja dhe Jeta dhe Prehja e shërbëtorëve të tu të fjetur o Krisht, Perëndi dhe Ty ta drejtojmë lavdinë bashkë me Atin tënd të pafillim, dhe Shpirtin Tënd të Tërëshenjtë, të mirë dhe jetëdhënës, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.



Studimi i Shkrimit të Shenjtë

Studimi i Shkrimit të Shenjtë

Në besimin orthodhoks ka shumë rëndësi studimi i Shkrimit të Shenjtë, Fjalës së Perëndisë.

Gjej një kohë kur nuk të shqetëson njeri, rreth 15 minuta ose më shumë, për t'u lutur dhe për të lexuar Biblën.

Fillo me këtë lutje:

Lutje për ndriçim

○ Zot njeridashës, bëj që të shkëlqejë në zemrat tona drita e kulluar e njohjes së hyjnisë sate dhe çel sytë e mendjes sonë për të kuptuar mësimet e tua ungjillore.

Futna dhe frikën e porosive të tua të lumtura, që pasi të shtypim të gjitha epshet trupore, të mundim të kalojmë një jetë shpirtërore, duke menduar dhe duke bërë të gjitha ato që të pëlqejnë.

Se Ti je ndriçimi i shpirtave dhe i trupave tanë, o Krisht Perëndi dhe ty ta drejtojmë lavdinë, bashkë me Atin Tënd pa fillim dhe Shpirtin Tënd të Tërëshenjtë, të mirë dhe jetëbërës, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.



Studimi i Shkrimit të Shenjtë

Leximi lutës i Shkrimit të Shenjtë e hap zemrën tënde në praninë e Perëndisë. Qëllimi i studimit biblik është hapja e mendjes dhe e zemrës te drita e Perëndisë, ndërsa lexon të vërtetat e Tij në Bibël. Pasi të kesh marrë Biblën, ndiq këto udhëzime:

⇒ **Z**gjidh një nga Ungjijtë, p.sh Ungjillin sipas Joanit dhe vendos të lexosh një ose dy kapituj rregullisht. Mund të lexosh edhe leximet e përditshme sipas kalendarit të Kishës.



⇒ **L**exo në mënyrë lutëse dhe me ngadalë.

Përqendrohu në ato që kupton dhe jo në ato që nuk kupton. Prania e Perëndisë do të të qartësojë.

⇒ **N**donjë varg që të pëlqen shkruaje në një bllok të veçantë shënimesh, mësoje përmendësh dhe kujtoje gjatë gjithë ditës.

⇒ **M**edito se si Perëndia mund të të flasë nëpërmjet fjalës së Tij në mënyrë të veçantë, lidhur me nevojat dhe rrethanat e tua.

⇒ **G**jatë leximit ndalo dhe ofro lutje të shkurtra falënderimi, ose kërkesa sipas frymëzimit të zemrës nga Shpirti i Shenjtë.

⇒ **M**und t'i bësh realitet të vërtetat që mësove nga leximi yt. Shkruaji në bllok këto të vërteta dhe mënyrat se si mund t'i bësh realitet. Pastaj kërko Perëndisë të të japë ndihmën e Tij për t'i vënë në praktikë.

⇒ **N**ëse gjatë leximit të dalin pyetje të rëndësishme, kërko udhëzime nga prifti yt, nga episkopi, ose nga një i krishterë orthodhoks që e njeh mirë besimin.

Studimi i Shkrimit të Shenjtë

Në fund ofro falënderimin e mëposhtëm:

Psalm falënderimi **Psalmi 137:1-3, 7-8**

Do të të lavdëroj, o Zot, me gjithë zemrën time, dhe përpara engjëjve do të psal për ty, se dëgjove gjithë fjalët e gojës sime.

Do të të falem në tempullin e shenjtërisë Sate, dhe emrin Tënd do të lavdëroj për përdëllimin Tënd, dhe për të vërtetën Tënde; se mbi çdo gjë emrin Tënd të shenjtë e madhërove.

Çdo ditë që do të thërres, dëgjomë shpejt; me fuqinë tënde, jepi forcë shpirtit tim.

Në mes të shtrëngimit në ecsha, jetë do të më japësh; kundër zemërimit të armiqve të mi duart e tua shtrive, dhe e djathta jote më shpëtoi.

Zoti do të marrë shpagim për mua; përdëllimi yt, o Zot, është përjetë; mos hiq dorë nga veprat e duarve të tua.



Lutja e Jisuit

O Zot Jisu Krisht, Bir i Perëndisë, mëshiromë.

ose

**O Zot Jisu Krisht, Bir i Perëndisë,
mëshiromë mua mëkatarin.**

Lutja e Jisuit është një lutje drejtuar Krishtit të gjallë. Në lutjen e Jisuit pohojmë Krishtin si Zot dhe i kërkojmë mëshirë.



Lutja e Jisuit është lutje e çdo të krishteri dhe mund ta thuash në çfarëdolloj rrethane apo momenti - i gjuhëzuar, i ulur, në këmbë, duke ecur, duke ngrënë, duke udhëtuar, duke bërë një punë apo kur shtrihesh për të fjetur.

Mund ta thuash gjithashtu gjatë pushimit në shkollë, në punë apo në shtëpi.

Mund ta thuash kur je duke bërë një shëtitje ose kur përgatit vaktet e ngrenies.

Efektshmëria e lutjes së Jisuit vjen si rezultat i fuqisë dhe hirit të Krishtit, i Cili e dëgjon lutjen tënde të zjarrtë, pastron zemrën tënde nga ligësia dhe vjen për të jetuar brenda teje si Zot personal.

Frytet e lutjes së Jisuit janë pendimi, falja, gëzimi, paqja dhe mbi të gjitha dashuria për Jisu Krishtin dhe për të gjitha krijesat e Perëndisë.

Lutja e Jisuit

Kulmin, lutja e Jisuit e arrin kur bëhet një lutje e vazhdueshme, një lutje e fshehtë, një lutje e zemrës, një frymëmarrje e pandërprerë e Shpirtit të Shenjtë që lutet brenda teje, një energji shpirtërore e të krishterit në gjithçka.

Kur lutesh në një vend të qetë, kjo lutje mund të thuhet ritmikisht me frymëmarrjen, në mënyrë që të krijohet një vëmendje e brendshme.

Kur merr frymë lutu *“O Zot Jisu Krisht, Bir i Perëndisë”*, dhe kur nxjerr frymë *“mëshiromë mua mëkatarin”*.

Por gjëja më e rëndësishme është vëmendja e vazhdueshme te fjalët e lutjes dhe te thirrja e zjarhtë drejtuar Krishtit.

Ki besim te mëshira dhe dashuria e Perëndisë!

Kërko praninë e Krishtit në zemrën tënde!

Lutju Krishtit me qetësi dhe pa nxitim, duke i drejtuar ndjenjat dhe mendimet te fjalët e lutjes së Jisuit!



Përgatitje për Rrëfimin e Shenjtë



Shkrimi i Shenjtë na nxit të pendohemi dhe të rrëfejme mëkatet tona.

“Pendohuni dhe braktisni tërë shkeljet tuaja...dhe bëjini vetes një zemër të re dhe një shpirt të ri” (Ezekieli 18:30-31).

“Lahuni dhe pastrohuni...mos bëni më keq, mësoni të bëni të mirën”(Isaia 1:16-16).

“U mbush koha dhe mbretëria e Perëndisë është afër, pendohuni dhe besoni Ungjillin” (Marku 1:15).

“Po t’i rrëfejme mëkatet tona, ai është besnik dhe i drejtë që të na falë mëkatet dhe të na pastrojë nga çdo paudhësi” (I Joani 1:9).

Pendimi është një kthim te vetja dhe Perëndia, burimi i jetës. Fjalët biblike që përdoren për pendimin na sugjerojnë një “kthim” të plotë, një “ndryshim rrënjësor të mendjes”, duke braktisur veprat dhe mendimet e këqija dhe duke filluar një mënyrë të re jetese, nëpërmjet hirit të Perëndisë. Jisui thekson gëzimin në pendim, për shkak të rezultateve të tij: falje, pajtim, rilindje jete dhe komunikim personal me Perëndinë.

Etërit e Kishës flasin për pendimin si *“hyrje për në parajsë, pagëzim të dytë, rilindje dhe rinovim të shpirtit”*.

Ata gjithashtu na mësojnë se pendimi është një pjesë e përhershme e jetës së krishterë dhe meqenëse asnjë nuk është i përkryer, çdo njeri duhet të pendohet dhe të rrëfejë shpesh mëkatet e tij.

Misteri i Rrëfimit

Pendimi është dhuratë e Perëndisë. Megjithatë kjo dhuratë duhet kërkuar. Djali plangprishës “erdhi në vete” dhe tha: *“Do të çohem dhe do të shkoj tek im atë”* (Llukai 15:17-18). Duke e bërë realitet vendimin e tij ai shkoi, rrëfeu mëkatet dhe u mirëprit plot gëzim nga i ati, u prit si dikush që vinte nga vdekja në jetë (Llukai 15:22-24).

Eja te Perëndia me pendim sa herë që të jesh i rënduar nga mëkati apo faji, ose sa herë që të ndihesh i humbur apo i ndarë nga Perëndia!

Rrëfeji Atij mëkatet e tua!

Ji specifik dhe vendos të bësh të pamundurën për të mos i përsëritur ato!

Beso që Perëndia do të të presë me krahët hapur dhe se do të ketë më shumë gëzim në qiell për pendimin tënd, se sa për nëntëdhjetë e nëntë të drejtët që nuk kanë nevojë për pendim (Llukai 15:7).



Lutja e Manaseut

Kjo është një lutje klasike pendimi, të cilën tradita ia atribuon Manaseut, një mbreti të pandershëm të Judesë (II Kronikat 33:11- 13), i cili iu lut Perëndisë t'i falë mëkatet e tij të shumta.

O Zot i gjithëfuqishëm, Perëndi i Etërve tanë, Abraham, Isak, Jakov edhe farës së tyre; që ke bërë qiellin e dheun me tërë botën e tyre; që e ke lidhur detin me urdhrin tënd; që e mbylle avushën dhe e vulose me emrin tënd; që tremben dhe dridhen të gjitha nga fuqia jote; se madhështia e lavdisë sate nuk ka kufi; se zemërimi yt kundër mëkatarëve nuk është i rëndë dhe mëshira jote është e pamundur dhe e pagjurmësuar;

Se ti je Zot i lartë, i dhembshur, zemërgjerë, mëshirëplotë edhe i butë për ligësitë e njerëzve; se ti u premtove ndjesë mëkatarëve pas mirësisë sate; se ti u fale pendimin mëkatarëve për shpëtimin e tyre; edhe këtë pendim nuk e fale për të drejtët, për Abrahamin, Isakun, Jakovin, të cilët nuk mëkatuan përpara teje, por për mua mëkatarin, që kam bërë më tepër mëkate se rëra e detit.

Janë rritur paudhësitë e mia, o Zot, janë rritur paudhësitë e mia dhe nuk jam i oyer t'i ngre sytë dhe të shoh lartësinë e qiellit; jam kërrusur prej paudhësive si prej një vargoi të rëndë prej hekuri; nuk kam prehje, se ta ndeza zemërimin; se e bëra të keqen përpara teje; se ta shkela dashurinë; se nuk i ruajta porositë e tua.

Po tani të përgjunjem me zemër, dhe i lutem mirësisë sate: Mëkatova, o Zot, mëkatova dhe i njoh paudhësitë e mia, dhe të lutem: Ndjemë, o Zot, falmë dhe mos më humb për tërë jetën sipas ligësive të mia dhe mos më dëno në fundin e dheut më të përposhtëm.

Se Ti je Perëndia im, Perëndia i atyre që pendohen dhe Ti do të më shpëtosh pas mëshirës sate, ndonëse jam i pavyer dhe Ty do të të lavdëroj gjithë ditët e jetës sime.

Se ty të këndojnë gjithë forcat e qiellit edhe jotja është lavdia në jetë të jetëve. Amin

Përgatitje për Rrëfim

Dhurata e faljes së Perëndisë merret nëpërmjet lutjeve personale, adhurimit të përbashkët, disiplinës së lutjes dhe kreshmimit, veprave penduese dhe mbi të gjitha nëpërmjet misterit të Rrëfimit të Shenjtë.

Vlera e Rrëfimit të Shenjtë është e dyanshme:

Së pari, nëpërmjet këtij veprimi misterial, midis priftit të dorëzuar (hirotonisur) dhe teje, si besimtar i krishterë, merr sigurinë e faljes hyjnore, sipas fjalëve të Krishtit (Joani 20:23).

Së dyti, Rrëfimi i Shenjtë të jep mundësinë për të biseduar për problemet e tua më të thella, për të marrë këshilla dhe për t'u inkurajuar në rritjen tënde shpirtërore.

Rrëfimi i Shenjtë mund të bëhet sa herë që e ndien të nevojshme. Ai është gjithashtu pjesë e përgatitjes tënde shpirtërore gjatë periudhës së Kreshmës, që na udhëheq në festat e mëdha të Pashkës, Krishtlindjes, Fjetjes së Hyjlindëses, apo Festës së dymbëdhjetë apostujve.

Rrëfimi i Shenjtë është i nevojshëm

a) kur ke kryer një mëkat serioz;

b) kur një mëkat i zakonshëm të ka shkatërruar

c) kur nuk vazhdon të rritesh shpirtërisht dhe ke nevojë të rivlerësosh përparësinë tënde.

Ti i rrëfen mëkatet Perëndisë dhe fuqia falëse është e Tij. Megjithatë, dhurata e faljes së Perëndisë, pavarësisht se është e sigurt, nuk është magjike. Ajo nuk të çliron automatikisht nga përpjekja jote shpirtërore - vigjilenca e vazhdueshme kundër së keqes dhe lufta e pandërprerë kundër mëkatit.

Misteri i Rrëfimit

Rrëfimi i Shenjtë do të japë fryte, vetëm nëse ti e urren të keqen, nuk pranon mëkatin dhe me durim kultivon zakone pozitive në jetën tënde me Krishtin.

“Kështu edhe ju, konsiderojeni veten të vdekur për mëkatin, por të gjallë për Perëndinë, në Jisu Krishtin, Zotin tonë. As mos i jepni gjymtyrët tuaja në shërbim të mëkatit si mjete paudhësie, por tregoni veten tuaj te Perëndia, si të gjallë prej së vdekurish dhe gjymtyrët tuaja si mjete drejtësie për Perëndinë” (Romakëve 6:11,13).

Si mund të përgatitesh për Rrëfimin e Shenjtë?

Përgatitja për rrëfimin është një vlerësim lutës i ndjenjave, mendimeve, fjalëve, veprave, qëndrimeve, zakoneve, vlerave, përparësive, qëllimeve, drejtimeve dhe mënyrës së jetesës.

Ky vetëvlerësim lutës nuk përfshin vetëm jetën fetare personale, por edhe marrëdhënien familjare, aktivitetet sociale, sjelljen në punë, shkollë, çështjet e biznesit, përkushtimet politike, madje dhe kohën e dëfrimit, sepse e gjithë ekzistenca jote duhet të jetohet më Krishtin.

Qëllimi i këtij kërkimi të ndershëm në ndërgjegje nën dritën e Shpirtit të Shenjtë nuk është për të dënuar vetveten, por për të pohuar veten tënde të vërtetë në Krishtin, i cili të ka dhënë mundësinë për të hyrë në mëshirën dhe faljen e Perëndisë dhe të mësoi të jetosh për lavdi të Tij.

Loutu dhe mendo për rrëfimin tënd për disa ditë!

Loutju Perëndisë të të ndihmojë të dallosh mëkatet dhe të bësh një rrëfim të plotë të tyre!

Përpara rrëfimit bëj edhe lutjen e mëposhtme:

Lutje pendimi

O Zot Perëndia im, pohoj se kam mëkatuar kundër teje në mendime, fjalë dhe vepra dhe ligjin tënd të shenjtë pas dore e kam lënë, por tani me pendim po kthehem te dashuria dhe mëshira jote. Të lutem, falmi gjitha paudhësitë e mia dhe pastromë nga mëkati im.

Mbushe, o Zot, zemrën time me dritën e së vërtetës sate.

Bëmë të fortë me hirin tënd.

Mësomë të bëj dëshirën dhe vullnetin tënd. Amin



Tani pa justifikime apo vetëkeqardhje bëj një vlerësim lutës të ndërgjegjes sate për gjithçka.

Për ndihmë nën dritën e dhjetë urdhërimeve bëj një reflektim mbi jetën tënde.

Merr një laps e një letër dhe shkruaj mëkatet e tua, kështu që në kohën e kryerjes së misterit ti mund të bësh një rrëfim të plotë nga lista, pa çoroditje apo gabime të kujtesës.

Me qëllim që të të ndihmojë për misterin e Rrëfimit sugjerojmë të gjesh kohë të lirë, të ulesh në qetësi dhe me lutje të shqyrtosh jetën tënde, duke përdorur si drejtim udhëzimin e mëposhtëm:

Dhjetë Urdhërimet

1. Unë jam Zoti, Perëndia yt dhe nuk do të kesh perëndi të tjerë para meje.

A ka qenë Perëndia burimi, qendra dhe shpresa e jetës sime? A e kam vendosur veten, të tjerët apo gjëra të tjera përpara Perëndisë? A ka pasur raste mosbesimi në ekzistencën, dashurinë dhe mëshirën e Perëndisë? A ka pasur raste që nuk jam lutur te Perëndia, që nuk e kam adhuruar apo që nuk e kam falënderuar për bekimet e Tij? A jam përpjekur t'i shërbej Perëndisë dhe të ruaj besnikërisht urdhërimet e Tij? A kam lavdëruar dhe madhështuar Perëndinë nëpërmjet fjalëve dhe veprave të mia?

2. Nuk do të bësh asnjë shëmbëlltysë të asnjë gjëje dhe nuk do të përkulesh përpara tyre.

A kam vlerësuar ndonjë njeri apo ndonjë gjë më shumë se Perëndinë? A i kam dhënë ndonjërit apo ndonjë gjëje dashurinë, nderin dhe adhurimin që i takon vetëm Perëndisë? A kam bërë idhull ndonjë njeri, ide, preokupim apo gjë?

3. Nuk do ta përdorësh emrin e Zotit, të Perëndisë tënd kot.

A e kam blasfemuar në ndonjë farë mënyre emrin e Perëndisë? A kam bërë be të rreme? A kam thyer ndonjë premtim apo betim solemn? A kam hyrë në ndonjë marrëveshje, premtim apo kontratë kundër ligjit të Perëndisë? A kam mallkuar apo përdorur gjuhë të keqe?

4. Mbaje mend ditën e shtunë për ta shenjtëruar.

A e kam kryer në rregull adhurimin të dielave apo në festat e mëdha dhe a i kam ndihmuar të tjerët të bëjnë kështu?

A kam punuar panevojshmërisht të dielave apo gjatë festave të mëdha dhe a jam bërë shkak që të tjerët të veprojnë kështu? A kam bërë gjatë ditës së Zotit gjëra që janë të shëndetshme dhe që e kënaqin Perëndinë?

5. Do të nderosh atin tënd dhe nënën tënde.

A i kam dashur dhe respektuar prindërit e mi ashtu siç duhet? A i kam neglizhuar apo nuk i kani ndihmuar? A kam bërë mosbindje kundrejt tyre, i kam mashtruar apo i kam shkaktuar dhimbje me anë të veprave dhe fjalëve të mia? A i kam trajtuar të gjithë anëtarët e familjes me durim dhe me dashuri?

6. Nuk do të vrasësh.

A kam shkaktuar lëndimin, plagosjen apo vdekjen e dikujt? A kam dëshiruar vuajtjen apo vdekjen time apo të ndonjë njeriu tjetër? A kam qenë i poshtër me kafshët dhe a kam shkatërruar ndonjë jetë pa qenë nevoja?

7. Nuk do të shkelësh besnikërinë bashkëshortore.

A kam kryer ndonjë veprë imorale me veten apo të tjerët? A u kam shkaktuar të tjerëve kryerjen e veprave imorale? A kam kryer vepra imorale në zemrën time?

8. Nuk do të vjedhësh.

A kam marrë ndonjë gjë që nuk ka qenë imja nga ndonjë njeri apo vend? A kam mashtruar apo kopjuar? A jam bërë shkak që të tjerët të vjedhin apo kopjojnë? A jam përpjekur të gjej të zotin e gjërave që kam gjetur? A kam dëmtuar apo shkatërruar ndonjë gjë që u përket të tjerëve? A ia kam marrë me mashtrim ndonjërit rrogën? A i kam paguar borxhet? A kam dhënë tek të varfrit apo për qëllime filantrropike një përqindje të të ardhurave të mia?

9. Nuk do të bësh dëshmi të rreme.

A kam bërë dëshmi të rreme kundër ndonjërit? A kam folur keq, a kam thënë gënjeshtër, apo kam hapur thashetheme për ndonjë? A i kam treguar ndonjërit mëkatet apo gabimet e ndonjë tjetri. A jam përfshirë në thashetheme për gjëra të vogla?

10. Nuk do të dëshirosh gjërat e tjetrit.

A i kam parë me zili, xhelozë apo urrejtje talentet, arritjet apo gjërat që zotëron një tjetër? A kam dëshiruar rënien apo humbjen e të tjerëve nga qëllime të këqija apo për qëllime përfitimi? A jam brengosur që Perëndia ka dhënë më shumë bekime të tjerët sesa të unë?

Lutje përpara Kungimit

Lutje përpara Kungimit

(Përpara se të marrësh Kungimin e Shenjtë, gjej kohë për të thënë këtë lutje. Ji në paqe dhe mirë me të gjithë pjesëtarët e familjes, veçanërisht përpara se të marrësh dhuratën më të madhe nga të gjitha, Trupin dhe Gjakun e Zotit tonë Jisu Krisht. Pasi ta kesh marrë, kujtohu të falënderosh për këtë bekim.)

Besoj, o Zot, dhe pohoj se ti je me të vërtetë Krishti, Biri i Perëndisë së gjallë, që erdhe në botë për të shpëtuar mëkatarët, nga të cilët i pari jam unë.

Edhe besoj se ky është vetë Trupi yt i pastër dhe ky është vetë Gjaku yt i çmuar.

Të lutem pra, mëshiro më dhe ndjemi fajet, të bëra me dashje dhe pa dashje, me fjalë, me punë, me dije edhe pa dije; dhe bëmë të denjë të kungohem pa dënim me Misteret e tua të kulluara, për ndjesë mëkatesh dhe për jetë të amshuar. Amin.

Dhe duke shkuar të kungohesh, thuaj me zë të ulët këto vargje të Shën Simeon Metafrastit:



Ja te po shkoj në Kungatën hyjnore, mos më digj, o Krijues, kur të kungohem, se ti je zjarr që i djeg ata që s'janë të denjë. Po pastromë prej çdo njolle.

Në Darkën tënde mistike, o Bir i Perëndisë, merrmë sot pjesëtar; se nuk do t'ua them armiqve të tu Misterin, nuk do të të jap të puthur si Juda; por duke të pohuar si kusari, thërres: Kujtomë, o Zot në mbretërinë tënde.

Lutje përpara Kungimit

Tmerrohu, o njeri, kur shikon Gjakun hyjnor;
sepse është zjarr që djeg të padenjët.
Trupi hyjnor më ushqen dhe më hyjnizon,
më hyjnizon shpirtin dhe më ushqen mendjen mrekullisht.

Më ngazëllove me mall, o Krisht, dhe më ndryshove me dashurinë tënde të perëndishme; po digji dhe mëkatet e mia me zjarr të palëndshëm dhe bëmë të denjë të rrafshohem me gëzimin të ti, që të madhëroj duke kërcyer, të dy ardhjet e tua, o i mirë.

Ndër shkëlqimet e Shenjtorëve të tu, si do të hyj unë i padenji? Se në guxofsha të hyj bashkë në nusëroren, këmisha më tregon që s'është e dasmës dhe i lidhur do të nxirrem jashtë prej engjëjve. Pastro, o Zot, ndyrësinë e shpirtit tim dhe shpëtomë si njeridashës.

O Zot njeridashës, Zot Jisu Krisht, Perëndia im, të mos më bëhen për gjyq këto të Shenjta, ngaqë jam i padenjë; po për pastrim dhe shenjtërim shpirti dhe trupi dhe të bëhem i denjë për jetën dhe mbretërinë tënde të ardhshme. Është mirë për mua t'i ngjitem Zotit, dhe tek Zoti të vë shpresën e shpëtimit tim.

Në Darkën tënde mistike, o Bir i Perëndisë, merrmë sot pjesëtar; se nuk do t'ua them armiqve Misterin, as që do të të jap puthje si Juda; por si kusari po të pohoj: Kujtomë, o Zot, kur të vij në mbretërinë tënde.

Dhe kështu me shpresëtari të madhe, shko dhe kungohu.

**Urata Falënderimi pas Kungimit
Shën Vasili i Madh**

Si të kungohesh me Dhuratat jetëdhënëse dhe mistike, himno menjëherë dhe falëndero me të madhe Perëndinë, duke thënë me zemër dhe shpirt këto:

Lavdi më ty, o Perëndi (3 herë)

Të falënderoj, o Zot Perëndia im, se nuk më le mua mëkatarin, po më bëre të denjë të jem pjesëtar i të Shenjtave të tua. Të falënderoj se më bëre të denjë, mua të padenjin, të kungohem me dhuratat e tua të kulluara dhe qiellore.

Po, o Zot njeridashës, ti që për ne durove vdekje, u ngjalle dhe na fale këto Mistere të frikshme dhe jetëdhënëse për të mirën dhe shenjtërimin e shpirtave dhe të trupave tanë, bëj që edhe për mua të jenë këto për shërim shpirti dhe trupi, për dëbim të çdo gjëje kundërshtare, për ndriçim të syve të zemrës sime, pastrim për fuqitë e mia shpirtërore, besë e paturpëruar, për dashuri pa hipokrizi, për urtësi të plotë, për ruajtje të porosive të tua, për shtim të hirit tënd hyjnor dhe për bashkim në mbretërinë tënde; që duke u ruajtur në shenjtërimin tënd me anën e këtyre, të kujtoj përgjithnjë hirin tënd e të mos rroj më vetëm për vete, po për ty, Zotin dhe mirëbërësin tim.

Dhe kështu, kur të lë këtë jetë me shpresën e jetës së përjetshme, të arrij në prehjen e përjetshme, ku ndihet papushim zëri i atyre që kremtojnë dhe ëmbëlsia e pafund e atyre që shikojnë bukurinë e patreguar të Fytyrës sate.

Se ti je dëshira e vërtetë dhe ngazëllimi i patreguar i atyre që të duan, o Krisht Perëndia ynë, dhe ty të himnon për jetë tërë krijesa. Amin.

Lutje pas Kungimit

Një uratë tjetër e Shën Vasilit:

○ Zot Krisht Perëndi, mbret i jetës dhe krijues i gjithësisë, të falënderoj për të gjitha të mirat që më ke dhënë dhe për kungimin me Misteret e tua të kulluara dhe jetëdhënëse.

Të lutem pra, o i mirë dhe njeridashës, ruajmë nën mbulesën tënde dhe nën hijen e krahëve të tu; dhe bëmë që gjer në frymën e fundit me mendje të pastër të kungohem denjësisht me të Shenjtat e tua për ndjesë të fajeve dhe për jetë të përjetshme; se ti je buka e jetës, burim i shenjtërimit, dhënës i të mirave dhe ty ta drejtojmë lavdinë bashkë me Atin e me Shpirtin e Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.





Lutje
për të falënderuar
Perëndinë për gjithçka

Shkurtore 1

Zot i paprishur, dora jote e djathtë kontrollon gjithë rrjedhën e jetës njerëzore, sipas akteve të Përkujdesjes sate për shpëtimin tonë. Të falënderojmë për të gjitha bekimet e tua, të ditura dhe të paditura, për jetën tonë tokësore dhe për gëzimet qiellore të mbretërisë sate të ardhshme. Prandaj, zgjate mëshirën tënde drejt nesh, që po të këndojmë: *Lavdi Ty, o Perëndi, në jetë të jetëve!*

Shtëpia 1

Frëmijë i dobët dhe i pambrojtur linda, por engjëlli yt, duke hapur flatrat e tij të ndritshme, e ruajti djepin tim. Qëkur linda, drita jote ndriçoi shtigjet e mia dhe mrekullisht më udhëhoqi drejt dritës së përjetshme. Që nga dita e parë e deri më sot, dhuntitë bujare të përkujdesjes sate mrekullisht më kanë mbuluar. Ty të jap falënderime, dhe bashkë me gjithë të tjerët që të njohin, thërres:

Lavdi Ty, që më krijove!

Lavdi Ty, që hape përpara meje bukurinë e gjithësisë!

Lavdi Ty, që nëpërmjet qiellit edhe dheut më zbulove librin e përjetshëm të urtësisë!

Lavdi përjetësisë sate, brenda kësaj bote fluturake!

Lavdi Ty, për bekimet e tua, të para e të papara!

Lavdi Ty, për çdo psherëtimë të brengës sime!

Lavdi Ty, për çdo hap në udhëtimin e jetës sime, për çdo çast gëzimi!

Lavdi Ty, o Perëndi, në jetë të jetëve!

Shkurtore 2

OZot, sa e mrekullueshme është të jesh i ftuari yt! Flladi erëmirë; malet që prekin qiejt; ujërat si pasqyrë e pakufishme; rrezet e arta të diellit dhe retë, që duke vrapuar, rrezatojnë. E gjithë natyra mistershëm mërmërit, ndërsa thith thellësitë e ëmbëlsisë; zogj dhe kafshë mbi vete mbajnë gjurmën e dashurisë sate. E bekuar je ti, o toka mëmë, në shkëlqimin tënd fluturak, që zgjon ndër ne zjarrin e lumturisë së përjetshme, në tokën, ku mes bukurisë që kurrë nuk mplaket, oshtin thirrja: *Aliluia*.

Shtëpia 2

Më solle në këtë jetë, si në një parajsë të magjepsur. E kemi parë qiellin, si një kupë blu, që tingëllon nga zogjtë në lartësitë kaltëroshe. Kemi dëgjuar fëshfërimën qetësuese të pyllit dhe muzikën tingullëmbël të ujërave. Kemi provuar frytin e shijshëm erëmirë dhe mjaltin ëmbëlkundërmues. Sa i këndshëm është qëndrimi ynë në tokë me Ty!; është gëzim të jesh i ftuari yt.

Lavdi Ty, për ditën festive të jetës!

Lavdi Ty, për parfumin e zambakëve dhe trëndafilave!

Lavdi Ty, për gjithë shijet e ndryshme të manave dhe të frutave!

Lavdi Ty, për argjendin vezullues të së hershmes vesë mëngjesore!

Lavdi Ty, për çdo zgjim me paqe dhe buzëqeshje!

Lavdi Ty, për jetën e përjetshme ndër ne, lajmësin e qiellit!

Lavdi Ty, o Perëndi, në jetë të jetëve!

Shkurtore 3

Me fuqinë e Shpirtit të Shenjtë, çdo lule përhap erën e saj të mirë. Parfumi kundërmues, ngjyra e brishtë, bukuria e tërë gjithësisë zbulohet gjer në imtësi. Lavdi edhe nderim Perëndisë, Jetëdhënësit, që mbulon fushat me qilimat e luleve, që kurorëzon rrafshinat me të korrat e arta dhe me flokët e misrit, dhe shpirtrat tanë me ngazëllimin e soditjes së tij. Ngazëllohuni dhe këndojni: *Aliluia*.

Shtëpia 3

Sa i lavdishëm je në triumfin pranveror, kur çdo krijesë i zgjohet një jete të re dhe gëzueshëm këndon lavdërimet e tua në mijëra gjuhë: Ti je burimi i jetës, ngadhënjimtari i vdekjes. Në dritën e hënës bilbilat këndojnë; lëndinat dhe pyjet veshin fustanin e nusërisë, të bardhë si dëbora. E gjithë toka është nusja jote e premtuar, e cila pret dhëndrin, që nuk njih prishje. Nëse bari ka veshur fushën kështu, sa i lavdishëm do të jetë transformimi ynë në jetën e ardhshme të ringjalljes; sa rrezatues trupat tanë, sa të shndritshëm shpirtrat tanë! Lavdi Ty, që nga terri i tokës ke nxjerrë një shumëllojshmëri të pafund ngjyrash, shijesh dhe erëmirash! Lavdi Ty, për ngrohtësinë dhe ëmbëlsinë e botës natyrore! Lavdi Ty, që na ke rrethuar me veprat e tua të panumërta! Lavdi Ty, për thellësinë e urtësisë sate; botë e tërë është shenjë e gjallë e saj! Lavdi Ty, në gjunjë, unë puth gjurmët e dorës sate të padukshme! Lavdi Ty, që shpalos para nesh dritën verbuese të jetës së përjetshme! Lavdi Ty, për shpresën e patregueshme dhe të paprishur të bukurisë së pavdekësisë!
Lavdi Ty, o Perëndi, në jetë të jetëve!

Shkurtore 4

Sa të ëmbëlsuar janë ata, që mendojnë tërë kohës për Ty; sa jetëdhënëse është Fjala jote e Shenjtë; të bisedosh me Ty është më çlodhëse se vajosja, më e ëmbël se vetë mjalti. Të luturit te Ti na ripërtërin dhe na jep flatra; nga zemrat tona vërshon ngrohtësi; një madhështi e mbushur me urtësi përshkon natyrën dhe gjithë jetën! Atje ku nuk je Ti, ka veç zbrazëti. Atje ku je Ti, shpirti mbushet me bollëk, dhe kënga e tij jehon si një përrua jete: *Aliluia*.

Shtëpia 4

Kur mbi tokë fashitet drita e diellit që perëndon, kur paqja e gjumit të përjetshëm dhe qetësia e ditës së plakur mbretëron mbi gjithçka, unë shoh vendbanimet e tua, si tenda të mbushura me dritë, që pasqyrohen në format e reve buzë muzgut: flakëruese dhe të purpurta, të arta dhe të kaltra, ato, si profetët, flasin për bukurinë e patregueshme të oborrit tënd qiellor, dhe solemnisht thërrasin: le të shkojmë tek Ati!

Lavdi Ty, në të qetën orë të mbrëmjes!

Lavdi Ty, që mbulon botën me paqe të thellë!

Lavdi Ty, për rrezën e fundit të diellit që perëndon!

Lavdi Ty, për prehjen e gjumit të lumtur!

Lavdi Ty, për mëshirën tënde, në mes të errësirës, kur gjithë bota është larguar prej nesh!

Lavdi Ty, për ndjenjën e ëmbël të shpirtit të prekur nga lutja!

Lavdi Ty, për premtimin e zgjimit, në ditën, që nuk njeh mbrëmje!

Lavdi Ty, o Perëndi, në jetë të jetëve!

Shkurtore 5

Stuhitë e jetës nuk i trembin zemrat e atyre, që digjen me dritën e flakës sate.

Jashtë është terri i vorbullës së erës dhe terrori i stuhisë ulëritëse, por në shpirtrat e tyre mbretëron qetësia dhe drita. Krishti është aty, dhe zemra këndon: *Aliluia*.

Shtëpia 5

Shoh qiellin tënd, që përflaket nga yjet. Sa i pasur që je, sa shumë dritë që ke! Përjetësia më vështron me anën e rrezeve të yjeve të largëta: jam i vogël, i parëndësishëm, por Zoti është me mua, dora e tij e dashur më mbron ngado që të shkoj.

Lavdi Ty, për përkujdesjen në çdo kohë!

Lavdi Ty, për njerëzit, që Përkujdesja jote më bëri të takoj!

Lavdi Ty, për dashurinë e të dashurve të mi, për besnikërinë e miqve!

Lavdi Ty, për butësinë e kafshëve që më shërbejnë!

Lavdi Ty, për çastet e jetës të mbushura me dritë!

Lavdi Ty, për gëzimin rrezatues të zemrës sime!

Lavdi Ty, për gëzimin e jetës, të lëvizjes e të parit!

Lavdi Ty, o Perëndi, në jetë të jetëve!

Shkurtore 6

Sa i madhërisëm dhe i sa i afërt je në shtegun e vështirë të stuhisë; sa i fuqishëm shfaqet krahu yt i djathtë në flakërimën verbuese të rrufesë; sa e frikshme është madhështia jote! Zëri i Zotit ndihet sipër fushave dhe në mes të pyjeve shushuritëse; zëri i Zotit është në lindjen e bubullimës dhe të shiut; zëri i Zotit është mbi gjithë ujërat. Lavdi Ty, në oshtimën e maleve që përflaken! Ti e shkund botën si të ishte një rrobë. Ti i lartëson deri në qiell dallgët e detit. Lavdi Ty, që e përul kryelartësinë e njeriut, dhe nga zemra e tij nxjerr thirrjen e pendimit: *Aliluia*.

Shtëpia 6

Kur flakërima e rrufesë mbush me dritë sallën e festës, e dobët ngjan drita e llambave. Po kështu, në mes të gëzimeve më të fuqishme të qenies sime, papritmas, Ti bën të përshkëndisë shpirti im. Pas dritës sate verbuese, sa të pakta, të zbehta dhe të rreme duken gjithë këto gëzime! Gjithë pasion, shpirti im rend pas teje. Lavdi Ty, Qëllimi, në të cilin ëndrrat më të larta të njerëzimit përmbushen!

Lavdi Ty, për etjen tonë të pashuar për shoqërinë tënde!

Lavdi Ty, që bën të mos kënaqemi nga gjërat tokësore!

Lavdi Ty, që na vesh me rrezet më të shkëlqyeshme të dritës sate!

Lavdi Ty, që shkatërron fuqinë e shpirtrave të errësirës dhe e bën ligësinë pre të shkatërrimit!

Lavdi Ty, për gëzimin, që ndiejmë kur dëgjojmë zërin tënd, për lumturinë e pranisë sate dhe për jetën me dashurinë tënde!

Lavdi Ty, o Perëndi, në jetë të jetëve!

Shkurtore 7

Në mes të rrapëllimës së tingujve të ndryshëm, dëgjojmë thirrjen tënde. Në mes të harmonisë së shumë zërave, trazuar nga tone muzikore, hutuar nga krijimtaria artistike, prej teje mësojmë madhështinë e melodisë dhe të këngës dhe parashijojmë mbretërinë e ardhshme. Çdo bukuri e vërtetë tërheq shpirtin drejt teje, me një përgjirim të fuqishëm, dhe e bën të këndoje me ngadhënjim: *Alilua*.

Shtëpia 7

Zbrazja e Shpirtit të Shenjtë ndriçon mendimet e artistëve, poetëve dhe shkencëtarëve. Mendjet e tyre të mëdha marrin prej teje mprehtësi profetike të ligjeve të tua dhe na zbulojnë thellësinë e urtësisë sate krijuese. Pa dashur, fjalët e tyre flasin për Ty; sa madhështor që je në gjithçka që ke krijuar, sa madhështor që shfaqesh te njeriu!

Lavdi Ty, që shpalos pushtetin tënd të pamatshëm në ligjet e gjithësisë!

Lavdi Ty, sepse gjithë natyra përshkohet nga ligjet e tua!

Lavdi Ty, për atë që na ke zbuluar nga mirësia jote!

Lavdi Ty, për gjithçka që urtësia jote e ruan të fshehur prej nesh!

Lavdi Ty, për shpikjet e mendjes njerëzore!

Lavdi Ty, për përpjekjen fuqizuese të punës!

Lavdi Ty, për gjuhët e zjarrta që sjellin frymëzim!

Lavdi Ty, o Perëndi, në jetë të jetëve!

Shkurtore 8

Sa i afërt je në ditët e sëmundjes; Ti vetë viziton të sëmurët; Ti vetë përkulesh mbi shtratin e të sëmurit; vetë zemra jote i flet atij. Me paqen tënde, Ti ndriçon shpirtin e rënduar nga vuajtjet dhe dhimbja; Ti dërgon ndihmë pa e pritur. Ti ngushëllon, Ti je dashuri, që sjell sprova dhe shpëtim, dhe Ty të këndojmë himnin: *Aliluia*.

Shtëpia 8

Ende fëmijë, kur të thirra me vetëdije për të parën herë, Ti dëgjove lutjen time dhe paqja e shenjtë zbriti në shpirtin tim. Atëherë e kuptova që Ti je i mirë; të bekuar janë ata që kthehen te Ti. Pareshtur, fillova të Të thërres, dhe tani Emrin tënd thërres:

Lavdi Ty, që kënaq dëshirat e mia me gjëra të mira!

Lavdi Ty, që më ruan ditë e natë!

Lavdi Ty, që zbut mundimet dhe fatkeqësitë me rrjedhën shëruese të kohës!

Lavdi Ty, s'ka humbje të pariparueshme, kur Ti je aty; të gjithëve Ti u jep jetë të përjetshme!

Lavdi Ty, që bën të pavdekshme gjithçka që është e lartë dhe e mirë, dhe që u premton mirëseardhjen të vdekurve!

Lavdi Ty, o Perëndi, në jetë të jetëve!

Shkurtore 9

Përse në ditë festive e gjithë natyra buzëqesh mistershëm?! Përse një ndriçim i mrekullueshëm, me të cilin asgjë tokësore nuk mund të matet, mbush zemrat tona; edhe vetë ajri mbi altar dhe ajri në shtëpinë e Perëndisë bëhet i ndritshëm?! Është fryma e hirit, rrezatimi i lavdisë së Malit Tabor; qielli dhe dheu këndojnë këtë lavdërim: *Aliluia*.

Shtëpia 9

Kur më frymëzon për t'i shërbyer të afërmit tim dhe bën që përlësia të shndritë brenda shpirtit tim, një nga rrezet depërtuese të dritës sate zbret në zemrën time, që paskëtaj flakërin si hekuri në furnaltë. E kam parë Fytyrën tënde të mistershme dhe të pakapshme.

Lavdi Ty, që ndryshon jetët tona me anë veprash dashurie!

Lavdi Ty, që i bën mrekullisht të ëmbla çdonjërin prej porosive të tua!

Lavdi Ty, që na dërgon dështime dhe mundime, që të bëhemi të ndjeshëm ndaj vuajtjeve të njerëzve!

Lavdi Ty, që premton shpërblime bujare për vepra të mira e të vyera!

Lavdi Ty, që mirëpret hovin e dashurisë së zemrave tona!

Lavdi Ty, që ke lartësuar dashurinë mbi gjithçka tjetër në tokë e në qiell!

Lavdi Ty, o Perëndi, në jetë të jetëve!

Shkurtore 10

Askush nuk mund të ribëjë atë që është shkërmoqur e bërë pluhur, por Ti mund të shërosh ndërgjegjen e shtrembëruar. Ti i rikthen shpirtit bukurinë e tij fillestare, që herët e kishte humbur, pa kurrfarë shprese ripërtëritjeje. Me Ty, asgjë nuk është e pashpresë. Ti je Dashuria. Ti je Krijuesi dhe Shpëtimtari i gjithë gjërave. Të lavdërojmë me këtë këngë: *Aliluia*.

Shtëpia 10

Perëndia im, Ti e di rënien e krenarit Luçifer. Shpëtomë me fuqinë e hirit tënd, mos më lër që të largohem prej teje, mos më lër që të vë Ty në dyshim. Mprihi veshët e mi, që në çdo minutë të jetës sime të mund të dëgjoj zërin tënd të mistershëm dhe të thërres Ty, o i kudopranishëm:

Lavdi Ty, për rrethanat fatlume!

Lavdi Ty, për paralajmërimet e dobishme!

Lavdi Ty, për mësimet e zërit tënd sekret!

Lavdi Ty, për zbulesat që na shpalos në ëndërr ose zgjuar!

Lavdi Ty, që shpërndan imagjinatat tona të kota!

Lavdi Ty, që, me anën e vuajtjeve, na çliron nga zjarri i pasioneve!

Lavdi Ty, që, për shpëtimin tonë, përul kryelartësinë e zemrës!

Lavdi Ty, o Perëndi, në jetë të jetëve!

Shkurtore 11

Përtej vazhdimësisë së akullt të kohërave, unë ndiej ngrohtësinë e Frymës sate hyjnore; dëgjoj qarkullimin e Gjakut tënd. Ti tashmë je afër meje; një pjesë kohe tashmë ka fluturuar. Unë shoh Kryqin tënd; është aty për hatrin tim. Shpirti im s'është gjë tjetër, veçse pluhur, para Kryqit tënd; ky është ngadhënjimi i dashurisë dhe shpengimit, këtu pareshtur dhe në të gjitha kohërat lartësohet lavdërimi: *Aliluia*.

Shtëpia 11

I bekuar është ai që do të marrë pjesë në Darkën Mistike të Mbretërisë sate, por edhe këtu në tokë Ti më ke falur të tillë bekim. Sa e sa herë, me vetë dorën tënde më ke dhënë Trupin dhe Gjakun tënd, dhe unë, edhe pse një mëkatar i madh, kam marrë këto Dhurata dhe kam ndier dashurinë tënde të patregueshme dhe të mbinatyrshme.

Lavdi Ty, për fuqinë e pakconceptueshme dhe jetëdhënëse të hirit tënd!

Lavdi Ty, që ke themeluar Kishën Tënde, si liman paqeje për një botë të munduar!

Lavdi Ty, që na ke dhuruar rilindje me anë të ujit jetëdhënës të Pagëzimit!

Lavdi Ty, që i rikthen atyre që pendohen dëlirësi të bardhë si një zambak i panjollë!

Lavdi Ty, humnerë e pamatshme e faljes!

Lavdi Ty, për kupën e jetës, për bukën e gëzimit të pasosur!

Lavdi Ty, që na lartëson drejt qiellit!

Lavdi Ty, o Perëndi, në jetë të jetëve!

Shkurtore 12

Më shumë se një herë, kam parë rrezatimin e lavdisë sate në fytyrat e të vdekurve. Çfarë bukurie, çfarë ngazëllimi qiellor rrezatonte prej tyre! Sa të ndritshme tiparet e fytyrës së tyre, tashmë të shndërruara në [tipare] shpirtërore! Ky ishte ngadhënjimi i lumturisë dhe i paqes së rigjetur; në qetësinë e tyre ata të thërrisnin Ty. Në orën e vdekjes sime, ndriço edhe shpirtin tim, i cili Të thërret: *Aliluja*.

Shtëpia 12

Sa i varfër është lavdërimi im para teje! Unë nuk e kam dëgjuar këngën e Keruvimit, një gëzim i ruajtur për shpirtrat e lartësuar, por unë i njoh lavdërimet që natyra të këndon Ty.

Në dimër, vë re, se si në mes të qetësisë së ndriçuar nga hëna, e gjithë toka, e mbështjellë në mantelin e saj të bardhë, të drejton lutje, që përshkëndisin si diamante.

Shoh diellin që lind te gëzohet në Ty, dhe dëgjoj koret e zogjve që ngrënë për Ty himne lavdie.

Dëgjoj pyllin, i cili për nderin tënd fëshfërin mistershëm, erërat i këndojnë lavdisë Sate, ujërat gurgullojnë dhe vargjet e yjeve shpallin Emrin tënd, ndërsa lëvizin në harmoni të përjetshme në thellësitë e hapësirës së pafundme.

Çfarë është adhurimi im para kësaj?

E gjithë natyra Ty të bën bindje, kurse unë jo; ndonëse gjatë gjithë jetës sime, shoh dashurinë Tënde dhe mezi pres të Të falënderoj, të të lutem dhe të thërres Emrin tënd.

Lutje falënderuese

Lavdi Ty, që na ke treguar dritën!

Lavdi Ty, që na ke dashur me një thellësi të pamatshme dhe me dashuri hyjnore!

Lavdi Ty, që na bekon me dritën, me shoqërinë e engjëjve dhe të shenjtorëve!

Lavdi Ty, Atë i tërëshenjtë, që na zbulon Mbretërinë tënde në porositë e Tua!

Lavdi Ty, Jisu Krisht, Shpëtimtar dhe Shpengues i botës!

Lavdi Ty, Shpirt i Shenjtë, dielli jetëdhënës i botës së ardhme!

Lavdi Ty, për gjithë gjërat, Trini e Shenjtë dhe e gjithëmëshirshme,

Lavdi Ty, o Perëndi, në jetë të jetëve!

Shkurtore 13

Trini jetëdhënëse dhe e shumëmëshirshme, priti falënderimet tona për të gjitha mirësitë e tua; bëna të denjë për bekimet e tua, që, pasi të kemi nxjerrë fitimin nga talentet që na ke besuar, të mund të hyjmë në gëzimin e përjetshëm të Zotit tonë, duke kënduar himnin ngadhënjimtar: *Aliluia*.

Mitropoliti Trifon Turkestanov, 1934



Shenja e kryqit



Kryqi është shenjë unike e besimtarëve të krishterë.

Krishtërimi feston dhe mëson që Perëndia e do krijimin kaq shumë, sa dërgoi Birin e Tij të bëhej njeri, që personalisht të hynte në jetën njerëzore dhe vuajtjet, të shkatërronte mëkatin dhe të keqen, që kishin hyrë në jetën tonë.

Çdo të dielë ne shpallim:

“Nëpërmjet kryqit gëzimi erdhi në tërë botën!”

Nëpërmjet kryqit Perëndia pushtoi botën me dashurinë e Tij.

Çdo i krishterë orthodhoks duhet të vetëvulohet me shenjën e kryqit dhe eksperiencës së kuptimit të kryqit në jetën e tij.

Shenja e kryqit bëhet me gishtin e madh dhe me dy gishtërinjtë e parë të dorës së djathtë (Perëndia është Tre Persona në një Hyjni: Ati, Biri dhe Shpirti i Shenjtë) dhe dy gishtërinjtë në pëllëmbën e dorës na kujtojnë se Biri i Perëndisë “erdhi nga qielli” në tokë si Perëndi dhe njeri, që të bashkonte natyrën tonë të rënë me Natyrën e Tij Hyjnore.



